

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

SHPLLJE POZICIONI VAKANT

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës, shpall procedurën e konkurimit për vendin e lirë të punës për pozicionin:

Specialist I, Drejtoria e Kontrollit të Terrenit, Zona V (Kategoria e pagës III-b).

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”(i ndryshuar); VKB Nr.169 datë 24.12.2021 “Për Organizimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës; Urdhër Nr.414, datë 06.01.2023 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë;

Kërkesat e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve :

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar ;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje ;
- Diplomë (Bachelor + Master Profesional/Shkencor) ose Diplomë e Nivelit të Dytë, (për diplomat jashtë vendit, të përcillet njëhësi nga MAS);
- Të ketë njohuri të mira të paketës Microsoft Office;
- Zotërimi i nje gjuhe të huaj përben avantazh;
- Të ketë aftësi të mira drejtuese,menaxhuese, raportuese, komunikimi dhe të punës në grup;

Specialist I ka për detyrë si më poshtë:

- Specialist I varet direkt nga Përgjegjësi i Sektorit.
- Specialist I ka këto detyra kryesore:
 - a. Kontroll të territorit të Bashkisë Tiranë në lidhje me situatën ndërtimore.
 - b. Inspekton në mënyrë të vazhdueshme territorin e Njesisë Administrative në të cilin është caktuar nga Drejtori i Kontrollit të Terrenit dhe Kryeinspektori.
 - c. Trajton ankesat e marra nga institucionet qendrore, vendore dhe subjektet fizik dhe juridik. Merr masa për zgjidhjen e tyre.
 - d. Zbaton programin e punës të hartuar nga Përgjegjësi i Sektorit, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në fushën e inspektimit.

Dokumentat që aplikanti për Specialist I në Drejtorinë e Kontrollit të Terrenit, Zona V, duhet të paraqesë janë si më poshtë:

1. CV;
2. Kopje ID;
3. Diplomë (Bachelor + Master Profesional/Shkencor) ose Diplomë e Nivelit të Dytë, dhe listë notash të noterizuara (*për diplomat jashtë vendit të përcillet njehsimi nga MAS*);
4. Çertifikatë personale dhe familjare;
5. Librezë pune origjinale;
6. Raport mjeko – ligjor;
7. Dëshmi penaliteti;
8. 2 fotografi;
9. Çertifikata, kualifikime etj (nëse dispononi);

Dërgimi i dokumentacionit do të bëhet pranë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit në adresën : Rr. “Abdi Toptani”, 1001, Tiranë, afati është deri me datë 15.02.2024 **ora: 16.30**